

Prof. dr. Frashër DEMAJ

ALTERNATIVAT E DIPLOMACISË SË FUQIVE TË MËDHA PËR KUFIRIN SHQIPTARO-MALAZEZ NË KONFERENCËN E AMBASADOREVE NË LONDËR.

Qeveritë e Aleancës ballkanikë, në fund të dhjetorit 1912 dhe në fillim të janarit të vitit 1913 i paraqitën Konferencës pikëpamjet e tyre mbi ndryshimet territoriale që duhej të bëheshin në Gadishullin Ballkanik. Në këto pikëpamje u paraqiten edhe pretendime pushtuese ndaj tokave shqiptare kryesisht nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia¹.

Problemi i caktimit të kufijve të shtetit të ri shqiptar ishte pika më e ndjeshme e Konferencës së Ambasadorëve në Londër e cila shqyrtoi problemin e kufijve qysh në seancën e parë të saj më 17 dhjetor 1912. Kufijtë e shtetit shqiptar hapen një debat shumë të ashpër diplomatik në mesin e Fuqive të Mëdha të cilat duke mbrojtur pozicionet e veta diplomatike shfaqnin alternativat përkatëse për caktimin e kufijve të shtetit shqiptar. Deklarata e ambasadorit rus se, Rusia hiqte dorë nga kërkesa për t'i dhënë Serbisë portin e Durrësit në sovranitet të saj, krijoi përshtypjet sikur ky problem do të zgjidhej lehtë, përballë lëshimeve reciproke. Por më vonë dolën në shesh kontradiktat e mëdha midis tyre, meqë aleatët e Rosisë në Ballkan këmbëngulnin në copëtimin e tokave shqiptare dhe përfshirjen brenda kufijve të tyre.

Duke treguar përshtypjet e tij mbi diskutimet e para të çështjeve kufitare Eduard Grey i shkruante ambasadorit anglez në Berlin më 17 dhjetor 1912 me shumë pesimizëm se kjo çështje do të vështirësojë punimet e konferencës². Për këtë qëllim ai kërkonte ndërhyrjen e Gjermanisë për të zbutur qëndrimin e Austrisë. Austria kërkon që çështja të zgjidhet me koncesionin e Prizrenit dhe Pejës, ndërsa do të zgjidhet më shpejt në qoftë se Shkodra do t'i jepej Malit të Zi.”³

Problemi i kufijve të Shqipërisë në Konferencën e Londrës nuk u shtrua mbi parimet etnografike, historike, ekonomike apo strategjike, por mbi interesat dhe qëllimet e shovinistëve fqinjë dhe të implementimit të interesave strategjike të Fuqive të Mëdha. Me këto akte shihej se shqiptarëve

¹ *Historia e Popullit Shqiptar ...III*, f. 21.

² AIHT, A-IV-218.

³ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 52.

pak iu njihej e shumë ju merrej nga të drejtat e tyre të patjetërsueshme siç ishte e drejta për të pasur shtet kombëtar në kufijtë etnik ashtu siç kjo e drejtë iu kishte njohur pothuajse të gjithë popujve të Ballkanit.

Nga telegrami që Eduard Grey i dërgonte ambasadorit anglez në Beograd, Paget, ndër të tjera i thoshte: "i ngarkuari me punë i Serbisë më njoftoi sot se si rezultat i luftës ballkanike Serbia do të marrë "Serbinë e vjetër" që përmbledh vilajetin e Kosovës, sanxhakun e Novi Pazarit, si edhe pjesën veri perëndimore të Shkodrës, duke përfshirë portin e vjetër serb të Durrësit, Shëngjinit dhe Lezhën..." Dhe më poshtë... "Unë i thash se... neve nuk kemi ndonjë rezervë për të bërë, por preferojmë një zgjidhje paqësore..."⁴

Gjithashtu, ministri Grey njoftonte: "Pas mbledhjes së parë të ambasadorëve, unë njoftova ambasadorët e Austrisë dhe Gjermanisë se pas vendosjes së marrëveshjes për daljet serbe në Adriatik, unë do të përkrah ambasadorin rus në qoftë se do të diskutohet për dhënien e Shkodrës Malit të Zi"⁵. Ndërsa në telegramin nr. 1, të datës 1 janar 1913 të dërguar nga Ambasadori Bukanan E. Grey dhe A. Nikolson kishin vënë këtë shënim. "Neve i kemi premtuar Ruisë përkrahjen tonë dhe tani nuk mund të tërhiqemi⁶. Pra, diplomacia britanike ishte e bindur se kërkesat serbe dhe mbështetja ruse nuk ishin reale as të drejta por meqë Rusia dhe Britania e Madhe ishin afruar mes vete për shkak të krijimit të dy grupimeve politike të interesit në kuadër të Fuqive të Mëdha, Londra ndihej e obliguar ta përkrahte Perandorinë Ruse si "aleat" që u gjenden në të njëjtin bllok politik e ushtarak.

Çështja e kufijve të shtetit të ri shqiptar u shtrua përsëri në Konferencën e Ambasadorëve më 20 dhjetor 1912. Ambasadori i Austro-Hungarisë Mensdorf propozoi që Mali i Zi të mbetej me kufijtë që kishte pasur me Turqinë. Atij iu përgjigj menjëherë ambasadori rus Benkendorf, i cili kërkoi zgjerimin e kufijve të Serbisë dhe Malit të Zi.

Plani rus, Eduard Greyt i ishte paraqitur qysh në fillim të dhjetorit nga ambasadori Benkendorf, i cili i kishte dhënë edhe një hartë me hollësitë e projektit. Ministri Grey ishte shprehur se "kjo hartë dukej e shkëlqyeshme"⁷ dhe se Austria nuk kishte arsye të mos e pranonte. Prandaj edhe në Konferencë Grey bëri të gjitha përpjekjet që të aprovohej kërkesa e ambasadorit Benkendorf, sipas të cilit kufiri verilindor i Shqipërisë do të vazhdonte vijën nga liqeni i Ohrit drejt rrjedhjes së Drinit të Zi, për t'i lënë

4 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 142.

5 Erik Goldstein & B.J.C Mc Kercher, Power and Stability, *British Foreign Policy 1865-1965*, London, 2005, f. 75.

6 AIHT, A-IV-218.

7 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 374

Shqipërisë Dibrën dhe në fund të vazhdohej Drini i Bardhë gjer në Bunë e drejt në Adriatik.

Lufta më e ashpër u zhvillua mbi çështjen e Shkodrës. Eduard Grey, donte të plotësonte me çdo kusht premtimin që i kish dhënë Rusisë që Shkodra të mos përfshihej në kufijtë e shtetit shqiptar por brenda kufijve të Malit të Zi.

Kërkesa e Vjenës për t'ia lënë Shkodrën Shqipërisë ndeshi në kundërshtimin e Rusisë të përkrahur nga Franca dhe Britania e Madhe⁸, të cilat të shumtën e rasteve ishin në akordim të plotë dhe meqë tash funksiononin si bllok politik që hartonte strategji dhe mbronte interesat e veta përballë grupimit tjetër gjerman, austriak e italian, shumë ide, propozime e vendime duhej t'i konsultonin parapakisht.

Italia përkrahte qëndrimin e Austro-Hungarisë mbi krijimin e shtetit të ri shqiptar, por në çështjen e Shkodrës ajo paraqitej e lëkundur për disa interesa specifike të saj. Megjithëse e pranonte që Shkodra ishte qytet shqiptar, Italia ishte dakord t'i lihej Malit të Zi, duke e justifikuar këtë me heqjen dorë të Rusisë nga kërkesa për t'i dhënë Serbisë portin e Durrësit.⁹ Pra, italianët më shumë interesoheshin që ta "shpëtonin" të pa cenuar vijën bregdetare ku kishin interesat e veta të shfaqura prej kohesh se sa për zonat që nuk përbënin ndonjë interes për diplomacinë italiane. Eduard Grey i shfrytëzoi këto interesa specifike të Italisë për të ushtruar presion mbi Austrinë, por me gjithë këtë Austria qëndronte e vendosur dhe pranoi të bënte lëshime vetëm në kufirin lindor, duke i dhënë Serbisë Prizrenin dhe Pejën që kish kërkuar ambasadori rus në mbledhjen e 17 dhjetorit¹⁰.

Ditët e para të Janarit të vitit 1913, ministri i Punëve të Jashtme të Italisë San Xhuliano njoftoi Grey'n mbi rezultatet e përpjekjeve pa sukses që kishte bërë qeveria italiane me Vjenën. Megjithëkëtë gatishmëria e Austrisë për të bërë lëshime në kufirin lindor, sidomos për Prizrenin dhe Pejën, i forconte besimin Greyt se Austria do të lëshonte pe nga këto pozita me kalimin e kohës¹¹.

Nga këto zhvillime shihej qartë se fati i kufijve të shtetit shqiptar nuk do të varej nga e drejta e tyre për kufijtë etnik, por nga lufta diplomatike dhe interesat e dy kampeve politike, Gjermani, Austro-Hungari dhe Itali në një anë dhe Britania e Madhe, Francë dhe Rusi në anën tjetër. Pra, fati i kufijve të shtetit etnik shqiptar po rrëshqiste gradualisht në arenën shpeshherë të pakompromis të rivalitetit të Fuqive të Mëdha dhe aleatëve të tyre të vegjël. Kjo rrëshqitje barte me vete edhe pikëpyetje të mëdha të cilat brenda vetes përfshinin rrezik të madh për shqiptarët.

⁸ *Historia e Popullit Shqiptar ...III*, f. 23.

⁹ *Po aty*

¹⁰ Sergej Dimitrijeviç Sazanov, *Kujtime... vep e cit. f. 120*

¹¹ AIHT, A-IV-218.

Më 22 Janar 1913, u zhvillua një takim tjetër i ambasadorëve për shqyrtimin e çështjeve të kufirit lindor. Austria e vendosur kishte kërcënuar se do të largohej nga konferenca në rast se do të kërkoheshin dorëzimi i Shkodrës Malit të Zi¹². Kërcënimi austriak e vuri në lëvizje edhe diplomacinë italiane e cila shqyrtoi edhe një herë qëndrimin e saj karshi shtrirjes gjeografike të shtetit shqiptar. Në këto kushte ambasadori italian ndryshoi qëndrimin e tij duke përkrahur Austrinë dhe ambasadorët u ndanë në dysh: Britania e Madhe, Rusia dhe Franca për projektin rus, ndërsa Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia kundër këtij projekti. Eduard Grey e pa se pengesat ishin të pakapërcyeshme dhe vendosi t'i propozojë konferencës pezullimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, për t'i lënë mundësi diplomacisë së fshehtë të kërkojë rrugët e zgjidhjes. Konferenca e ambasadorëve ishte njohur edhe me kërkesat e qeverisë së përkohshme të Vlorës, nëpërmjet memorandumit që ju dërgua më 2 janar 1913 kryetarit të Konferencës Eduard Grey. Në këtë memorandum shënohej me hollësi vija kufitare e shtetit shqiptar që niset nga kufijtë ekzistues të Malit të Zi, duke përfshirë Pejën, Mitrovicën, Prishtinën, Shkupin dhe pjesërisht Manastirin deri në Motzove, duke ruajtur kufijtë ekzistues gjër në Prevezë. Në memorandum bëhej edhe një paralajmërim se në rast se "do vihen në zgjedhje të huaj tokat ku popullsia shqiptare përbën shumicën, do të ishte përjetësimi i farës së grindjeve dhe turbullirave" Por ky memorandum u konsiderua si një akti i thjeshtë protokollar përballë interesave të Fuqive të Mëdha¹³, prandaj edhe nuk u mor fort parasysh.

Rruga e zgjidhjes së problemit të kufijve të Shqipërisë nëpërmjet kompromiseve dhe koncesioneve të ndryshme midis Fuqive të Mëdha, e bëri këtë vend në vazhdimësi objekt të synimeve grabitqare të vendeve të huaja. Që Shkodra banohej vetëm nga shqiptarët ky fakt ishte shumë i qartë edhe nga malazezët dhe rusët. Vetë ministri i Jashtëm Grey, më 14 janar të vitit 1913, në një bisedim që pati me ambasadorin rus e gjeti të vështirë të gjente qoftë edhe një argument për t'ia dhënë Shkodrën Malit të Zi. Edhe vetë ambasadori rus e pranoi që Shkodra është thjesht shqiptare por këmbënguli që t'i mbetej Malit të Zi, dhe në qoftë se kjo do të ishte e pamundur, të krijoheshin mundësi për kompensim të plot në kufirin lindor të Shqipërisë¹⁴.

Tri ditë më vonë, Eduard Grey bisedoi mbi këtë çështje hollësisht edhe me ambasadorin gjerman, princin Likhnowski (Lichnowsky). Në këtë takim (siç del nga telegrami që Grey i dërgoi po atë ditë ambasadorit Goshen

12 AIHP, Fondi: Dokumente Austro-Hungareze. Dosja nr. 3.

13 AIHT, A-IV-218.

14 Më gjerësisht për qëndrimin e Rusisë shih: Muhamet Shatri & Ramiz Abdylî, *Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912*, Prishtinë 2006.

(Goschen)¹⁵, E. Grey kishte kërkuar që të ushtrohej presion mbi Austrinë për të hequr dorë nga Shkodra, por ambasadori ishte përgjigjur se kjo ishte shumë e vështirë dhe i kish propozuar kompensime në kufirin lindor, duke dhënë në vend të Shkodrës, Pejën dhe Prizrenin. Eduard Grey përsëri kishte këmbëngulur që të hiqej dorë nga Shkodra dhe në këtë mënyrë problemi i kufijve lindorë do të zgjidhej lehtë. Ai kish nënvizuar se në rast se nuk hiqej dorë nga Shkodra, kompensimet territoriale në kufirin lindor vetëm me Prizrenin dhe Pejën nuk do të jenë të mjaftueshme dhe nuk do të pranoheshin nga Mali i Zi dhe Rusia¹⁶. Pra, rusët dhe malazezët nga një këndvështrim i tyre më shumë e vlerësonin Shkodrën se sa Prizrenin dhe Pejën se bashku. Këmbëngulja për Shkodrën vinte edhe si rezultat i pretendimeve të Serbisë për Kosovën të cilën ajo e quante “Serbi e Vjetër”. Andaj meqë Rusia mbështeste Serbinë edhe Malin e Zi, diplomacia e këtij vendi ishte e interesuar që sa më shumë territore të përfshiheshin brenda kufijve të aleatëve të saj ballkanik.

Pas bisedimeve që pati Eduard Grey me ambasadorin rus më 14 janar 1913 dhe ambasadorin gjerman, më 17 janar 1913, problemi i Shkodrës filloi të zgjidhej në rrugën e pazarllëqeve për revizionimin e kufijve lindorë të vendit. Megjithatë, krahas këtyre pazarllëqeve vazhdonin presionet për të mënjauar Shkodrën nga kufijtë e shtetit shqiptar dhe lënien e këtij qyteti brenda kufijve të shtetit malazez.

Përpjekjet e Antantës për t’i dhënë Shkodrën Malit të Zi, ndiqnin dy qëllime kryesore, në radhë të parë ata e kërkonin këtë për qëllimet strategjike dhe ekonomike. Por në qoftë se nuk do t’i arrinin këtij qëllimi, do të përdornin këtë për të bërë presion mbi Austro-Hungarinë për lëshime territoriale në kufijtë lindore, për shkak se e gjithë influenca e Austrisë shtrihej në zonat e Shkodrës në popullsinë katolike dhe dhënia e këtij rajoni Malit të Zi do të thoshte çrrënjosje e kësaj influence. Kjo ishte arsyeja që Austro-Hungaria nuk kishte ndërmend të hiqte dorë nga Shkodra dhe kërcënonte se në rast nevojë do të përdorte edhe forcat e saj të armatosura. Kjo vendosmëri e bënte qëndrimin britanik më të lëkundur karshi Peterburgut. Kështu filloi të zbutej edhe qëndrimi britanik për Shkodrën. Kështu, në telegramin që E. Grey i dërgoi ambasadorit të tij në kryeqytetin rus më 1 janar 1913 ndër të tjera i thoshte: “Unë tanimë e kam dhënë përkrahjen për Shkodrën... përsëri do të vazhdoj të përkrahë vijën ruse për kufirin lindor të Shqipërisë. Kjo, sigurisht, duhet të kuptohet, se nuk mund të japë më shumë se përkrahje diplomatike, se kjo çështje nuk mund të justifikojë një luftë evropiane”¹⁷ Pra, është e qartë se Britania e Madhe që

15 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 520.

16 Sergej Dimitrijeviç Sazanov, *Kujtime...* vep e cit. f. 121.

17 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the

e disponuar të jepte përkrahjen e saj, por vetëm në rrugën diplomatike dhe nga ana tjetër ajo linte të kuptohej se nëse çështja e Shkodrës do të mund të shërbente si shkas për ndonjë luftë të re atëherë Londra zyrtare ndryshonte qëndrimin e vet në favor të mbetjes së Shkodrës brenda shtetit shqiptar.

Ambasadori austriak kishte pranuar që nga kufijtë e Shqipërisë të hiqte dorë vetëm nga Prizreni, me kusht që t'i jepej përkrahje në pikat e tjera. Këtë qëndrim ai e theksoi edhe në mbledhjet e tjera. Por kur fuqitë e Antantës bënin presione për Shkodrën, duke hequr dorë nga kufijtë lindorë, Mensdorff filloi të lëshojë një nga një qytetet e lindjes. Pas Prizrenit ai lëshoi edhe Pejën, por se kjo nuk i kënaqte fuqitë e Antantës. Konti Benkendorf i deklaroi Eduard Greyt më 14 janar të vitit 1913 se nga Shkodra do të hiqej dorë vetëm në rast se do t'i jepej Serbisë satisfaksion i plotë në kufijtë lindor¹⁸. Në kuadër të këtij "satisfaksioni" përfshiheshin të paktën rrethet e Prizrenit, Pejës, Dibrës dhe Gjakovës.

Ministri i Jashtëm britanik Eduard Grey, si ndërmjetës bënte edhe më tej presione mbi Gjermaninë që të përdorë përsëri influencën e saj në Vjenë për një zbutje të mëtejshme të qëndrimit të saj. Më 31 janar 1913, Grey zhvilloi një diskutim të gjatë me ambasadorin gjerman Liknovski, ku i propozoi që Gjermania të pranonte zgjidhjen me kompromis duke i dhënë Malit të Zi Bunën dhe rajonin e Kastratit, ndërsa Serbisë t'i jepej vetëm Prizreni dhe Peja¹⁹.

Kompromisi i propozuar nga Eduard Grey nuk u pranua nga Austria për shkak se vendet që do të përjashtoheshin nga kufijtë e shtetit shqiptar kishin jo vetëm rëndësi strategjike, por ishin të populluara nga katolike ku shtrihej influenza austriake. Prandaj Austria kërkonte heqjen dorë nga Shkodra dhe rrethet e saj. Në këto kushte Eduard Grey bëri një propozim tjetër, pikërisht atë propozim që kërkonte Rusia²⁰, t'i lihej Shqipërisë Shkodra duke i kompensuar Serbisë Prizrenin, Pejën, Dibrën dhe Gjakovën. Për këtë propozim Eduard Grey kërkoi veçanërisht ndihmën e princit Liknovski, i cili u ngarkua të përdorë influencën e vet mbi Austrinë²¹. Ky qëndrim i Austrisë ishte bërë i qartë për Britaninë e Madhe qysh në dhjetor të vitit 1912, kur Ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë priti ambasadorin e Britanisë në Vjenë, F. Karturajt dhe i deklaroi se "Austria nuk është e interesuar për Janinën, por për Shkodrën"²². Me këtë deklaratë ai i kishte dhënë të kuptonte ambasadorit britanik se Austria në Shkodër ka interesat e

war 1898-1914, dok. Nr. 429.

18 Po aty, dok. Nr. 507.

19 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London. British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 581.

20 Sergej Dimitrijeviç Sazanov, *Kujtime... vep e cit. f. 122.*

21 Po aty

22 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London. British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 407.

saj të ngushta nga të cilat nuk mund të heqë dorë. Por në të njëjtën kohë kjo do të thoshte se për këto interesa të ngushta mund të bëhen edhe lëshime në pjesët e tjera territoriale të shtetit të ri shqiptar²³.

Propozimi i ri britanik pati reagime të shpejta në qarqet diplomatike të shteteve të mëdha. Ai u konsiderua si i pranueshëm edhe për Gjermaninë dhe Italinë, të cilët ushtronin influencën e vet mbi Austrinë. Por, Austria nuk mund t'i pranonte njëherësh këto për shkak të përshtypjes që do të krijohesh sidomos në opinionin publik shqiptar. Në këto kushte ajo pranoi të heqë dorë nga Prizreni, Peja dhe Dibra, ndërsa për Gjakovën deklaroi se nuk do të lejojë t'i shkëputej Shqipërisë.

Në muajin shkurt të vitit 1913, pazarllëqet midis Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë kishin arritur kulmin. Ambasadori gjerman, në një takim që pati me Eduard Grey, e njoftoi se qeveria e tij kishte bërë të gjitha përpjekjet për të bindur qeverinë austriake të hiqte dorë edhe nga Gjakova, por kjo nuk ishte e mundur. "Ajo mund të pranojë vetëm të lejë Gjakovën në shkëmbim me Dibrën, në rast se juve do të preferoni Gjakovën më shumë".²⁴ Koncesionet e reja austriake për Dibrën u shtruan edhe në mbledhjen e ambasadorëve të datës 6 shkurt 1913. Megjithatë kjo tregonte një hap përpara për arritjen e marrëveshjes, ambasadori rus nuk u kënaq dhe insistoi që Austria të hiqte dorë edhe nga Gjakova²⁵.

Me qëllim që të zgjidhej përfundimisht çështja e Shkodrës. Aleanca trepalëshe hartoi një plan të ri më pajtues, por përsëri Rusia këmbëngulte për Gjakovën. Në fillim të muajit mars 1913, Eduard Grey i bëri një propozim tjetër ambasadorit austriak që si shkëmbim për Shkodrën t'i lihej Shqipërisë Gjakova dhe Dibra, por ambasadori e kundërshtoi duke i thënë se për Shkodrën kemi bërë koncesione shumë të mëdha, duke i lënë Serbisë Dibrën, Pejën dhe Prizrenin.²⁶

Duke parë vështirësitë që i dilnin përpara, Eduard Grey i propozoi Qeverisë ruse më 4 mars 1913, që të jepte pëlqimin për formimin e një "Komisioni ndërkombëtar që të shqyrtonte problemin e Gjakovës"²⁷, meqë nuk po arrihej të gjendej një marrëveshje kompromisi.

Ndërsa ministri Grey po bënte përpjekje për gjetjen e një formule për zgjidhjen e problemit të Shkodrës duke bërë lëshime në kufijtë lindorë, gjendja në Shkodër ishte shumë e rrezikshme. Forcat e shumta malazeze që e kishin rrethuar këtë qytet qysh në muajin tetor të vitit 1912, tani ishin përforcuar me forca serbe dhe shtonin presionet mbi qytetet. Ata filluan

²³ AIHT, A-IV-218

²⁴ Erik Goldstein & B.J.C Mc Kercher, *Power and Stability, British Foreign Policy 1865-1965*, London, 2005, f. 77.

²⁵ AIHP, Fondi: Dokumente Austro-Hungareze, Dosja nr.3

²⁶ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 683.

²⁷ Po aty dok. Nr. 646.

të bombardonin edhe lagjet e qytetit. Megjithëkëtë mbrojtja e Shkodrës nuk lëkundej. Ushtarët shqiptarë që merrnin pjesë në mbrojtje, ishin të vendosur ngase këtij qyteti i ishin bashkuar edhe çetat kryengritëse që kishin luftuar kundër turqve. Ishte pikërisht kjo arsyeja që komandanti i fortesës së Shkodrës Hasan Riza bej i shkruante atasheut ushtarak austro-hungarez: “Moral i trupave të mi është i shkëlqyer. Fjala “rrethim” kurrë nuk përmendet... Unë jam i bindur se neve mund të mbrojmë qytetin gjer në fund të luftës, dhe mbrojtjen e tij neve do ta bëjmë...”²⁸.

Por, beteja për Shkodrën sillte me vete edhe një rrezik tjetër, përfshirjen e Austro-Hungarisë në këtë konflikt. Në këtë kohë qarkullonin lajme se ushtarë të shumtë austriakë po grumbulloheshin në kufi me Serbinë dhe se Austro-Hungaria e kish bërë të qartë se nuk do të lejonte pushtimin e Shkodrës. Veç operacioneve mbi qytet, Austro-Hungaria ndiqte me interesim edhe krimet që bëheshin për zhdukjen e popullsisë shqiptare. Në këto kushte, Eduard Grey i doli përpara situatës së rëndë që ishte krijuar, duke i shkruar sa vijon ambasadorit Bukanan në Peterburg për Qeverinë ruse:

“Është urgjente të ndalohet gjakderdhja në Shkodër dhe në të gjithë kufirin shqiptar. Raporte shumë të llahtarshme vinë nga koha në kohë... mbi masakrat e pushtuesve serbë... Prandaj propozoj bisedime të fshehta me Serbinë dhe Malin e Zi, ku t’u bëhet e qartë se parimet kryesore të kufirit janë zgjidhur nga Fuqitë e Mëdha dhe se asnjë veprim i tyre nuk do të ketë efekt. Fuqitë e Mëdha kanë ardhur në marrëveshje për të përjashtuar nga Shqipëria Pejën, Prizrenin dhe Dibrën. Por Shqipërisë do t’i jepet Shkodra, ndërsa çështja e Gjakovës do të mbetet për një kohë e pa vendosur”²⁹.

Krahas kësaj, Eduard Grey vazhdonte edhe presionet mbi Austrinë për të pranuar që edhe Gjakova, qyteti i fundit që kërkonte Rusia për kompensim të Shkodrës, të shkëputej nga shteti i ri shqiptar. Në të njëjtën kohë, i kërkoi Qeverisë ruse që të deklaronte publikisht se “po të vendoset çështja e Gjakovës, Rusia do të pengojë trupat e Malit të Zi që të marrin Shkodrën dhe do të sigurojë tërheqjen e trupave serbo-malazeze nga territoret që do t’i lihen Shqipërisë”³⁰.

E ndodhur përballë presioneve të vazhdueshme, Austro-Hungaria u tërhoq nga qëndrimi i saj dhe më 10 mars 1913 u njoftua Eduard Grey se: “Çështje kryesore për Austrinë është dhënia fund e përpjekjeve për pushtimin e Shkodrës, duke u tërhequr sa më parë trupat serbo-malazeze. Ndërsa çështja e Gjakovës të zgjidhet veçmas nga një komision...”³¹.

28 AIHT, A-IV-218.

29 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 688.

30 Sergej Dimitrijeviç Sazanov. *Kujtime...* vep e cit. f. 123.

31 Erik Goldstein & B.J.C Mc Kercher. Power and Stability. *British Foreign Policy 1865-1965...* vep e cit, f. 79.

Qëndrim i ri austriak u prit pozitivisht nga ana e diplomacisë ruse. Ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë, Sazonov, në një bisedim që pati me ambasadorin austro-hungarez në Peterburg, vendosi që krijimin e komisionit për çështjen e Gjakovës t'ia besojnë Eduard Greyt. Pas kësaj Sazonov thirri ambasadorin britanik Bukanan, duke i deklaruar se “i gjithë objekti i komisionit është shpërblimi i Austrisë duke gjetur ndonjë farë preteksti për t'i dhënë Gjakovën Serbisë.”³²

Eduard Grey e kishte të qartë se komisioni nuk mund të gjente asnjë argument apo shkas për t'i dhënë Serbisë Gjakovën, prandaj në telegramin e përgjigjes ambasadorit Bukanan i shkroi: “Për sa i përket emërimit nga ana ime të komisionit që do të përcaktonte se kujt i përket Gjakova, Shqipërisë apo Serbisë, një gjë e tillë do të më ekspozonte mua, për shërbim të keq dhe të njëanshëm”.³³ Grey e dinte se pa asnjë fije dyshimi Gjakova ishte qytet shqiptar dhe do të ishte padrejtësi t'i jepej Serbisë. Pas refuzimit të Greyt për krijimin e komisionit, Austro-Hungaria, e nxitur edhe nga fuqitë e tjera pranoi që t'i lerë Gjakovën Serbisë me kusht që të caktoheshin menjëherë kufijtë veriorë dhe lindorë të Shqipërisë, të pushonin menjëherë luftimet nga ana e ushtrive serbo-malazeze në tokat shqiptare dhe të fillonte tërheqja e tyre. Eduard Grey ja arriti qëllimit të tij pa rrezikuar asgjë. Më 22 mars 1913 ai e thirri përsëri Konferencë e Ambasadorëve për të komunikuar akordin e arritur i cili u ratifikua nga Fuqitë e Mëdha më 26 mars 1913³⁴.

Marrëveshja e Fuqive të Mëdha për Shkodrën pati një jehonë të madhe. Opinioni publik ndërkombëtar i konsideronte sakrificat të mëdha lëshimet e Austrisë në kufijtë lindorë. Por me gjithë këto, shovinistët malazezë nuk e ndienin veten të kënaqur dhe pa marrë parasysh deklaratën serbe që pranoi kushtet për tërheqjen nga Shkodra deklaruan në mënyrë të njëanshme se nuk do të hiqnin dorë nga ky qytet. Këto deklarime e acaruan edhe më shumë qeverinë e Vjenës e cila ishte tërhequr nga “kërkesat maksimaliste” për përfshirjen e territoreve brenda shtetit shqiptar.

Në kushtet e reja që u krijuan Austria filloi të marrë një qëndrim më të vendosur. Për të penguar pushtimin e Shkodrës ajo kërcënoi se do të përdorte forcat e saj ushtarake. Për këtë qëndrim tani ajo përdorte si mbështetje juridike edhe vendimin e Fuqive të Mëdha të 26 marsit.

Qëndrimin e saj Austro-Hungaria e kishte koordinuar edhe me Italinë dhe për marrëveshjet e arritura kishin vënë në dijeni partnerin kryesor të aleancës trepalëshe, Gjermaninë. Në qarqet e afërta diplomatike filluan të qarkullonin zëra se Austro-Hungaria do të sulmonte Malin e Zi, se midis saj edhe Italisë ishte arritur një marrëveshje e fshehtë për ndarjen midis tyre të Shqipërisë.

32 Më gjerësisht shih Sergej Dimitrijeviç Sazanov, *Kujtime... vep e cit.*

33 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 607, dok. Nr. 741.

34 AIHT, A-IV-218.

Përballë kësaj gjendjeje Qeveria britanike ndërmori hapa serioz. Më 18 mars, Eduard Grey formuloi "demarsh kolektiv" të drejtuar nga Konferenca e Ambasadorëve Qeverisë serbe dhe malazeze, duke treguar se "kufijtë e Shqipërisë janë rezervuar për t'u përcaktuar nga Fuqitë e Mëdha dhe gjerë në përfundim të kësaj Serbia dhe Mali i Zi nuk duhet të ndërmarrin ndonjë aksion në Shqipëri..." Por "demarshi kolektiv" përfundonte me versionin se: "në qoftë se Shkodra bie, destinimi i Shkodrës do të vendoset nga Fuqitë e Mëdha dhe jo nga okupatorë malazezë".³⁵ Me këtë formulim i bëhej thirrje Austro-Hungarisë të hiqte dorë nga përdorimi i forcës, pasi çdo gjë do të zgjidhej nëpërmjet Fuqive të Mëdha.

"Demarshi kolektiv" mbi Beograd dhe Cetinë nuk dha asnjë rezultat. Në ndërkohë Konferenca e Ambasadorëve e shqyrtoi gjendjen e krijuar në Shkodër edhe më 31 mars 1913. Ambasadori austriak këmbënguli për masa të vendosura, ndryshe Austria do të ndërhynte menjëherë për të përballuar rrezikun që i kanosej Shkodrës. Përballë kësaj situate, Eduard Grey propozoi procedimin kolektiv në një demonstrim naval në bregdetin shqiptar gjër në Tivar, me qëllim që gjoja t'i pritej rruga furnizimeve serbo-malazeze nga deti. Propozimi i tij u pranua me anën e një rezolute me këtë përmbajtje: "Mbledhja është e mendimit që të gjitha Fuqitë e Mëdha, të marrin pjesë në një demonstrim naval, duke proceduar dërgimin sa më parë në Tivar të anijeve të luftës".³⁶

Eduard Grey në këtë mbledhje deklaroi se do t'u jap urdhër kryqëzorëve që ndodhen të ankoruar në Korfuz të shkojnë sa më parë në Tivar, porsa të jetë informuar se një dërgim i tillë është bërë edhe nga fuqitë e tjera. Gjithashtu, ai pranoi sugjerimin që të instruktohen anijet e luftës pjesëmarrës në demonstrim naval të mos lejojnë anijet greke të transportojnë trupa dhe municione ushtarake për përforcimet serbo-malazeze në Shkodër. E. Grey u zotua të njoftojë menjëherë ambasadorin britanik në Athinë që të paralajmëronte për këto edhe Qeverinë greke.³⁷

Rezolutat e 31 marsit krijuan iluzione se Konferenca e Ambasadorëve po merrte masa efektive kundër Malit të Zi për zbatimin në praktikë të vendimeve të saj. Por kjo rezolutë jo vetëm që nuk drejtohej kundër Malit të Zi, por përkundrazi kish për qëllim mbrojtjen e Malit të Zi. Ajo synonte t'u jepte karakter ndërkombëtar të gjitha veprimeve në këtë territor, duke penguar ndërhyrjen eventuale të Austro-Hungarisë, për mbrojtjen e interesave të saj. Ajo u bë pikërisht në kohën kur Austro-Hungaria kishte

³⁵ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 600, dok. Nr. 732

³⁶ Erik Goldstein & B.J.C. Mc Kercher, Power and Stability, *British Foreign Policy 1865-1965...* vep e cit. f. 80.

³⁷ G. P. Gooch, D. Litt., and Harold temperley, Litt. D. with the assistance of Lillian M. Penson, PhD. *The Balkan Wars...* f. 50.

grumbulluar forca të shumta në kufi me Malin e Zi dhe po përgatiste dërgimin e flotës së saj ushtarake në Tivar.

Për Fuqitë e Mëdha ishte bërë e qartë se në situatën e krijuar ndërhyrja e armatosur e Austro-Hungarisë ishte një çështje kohe. Për këtë qëllim, Eduard Grey propozoi demonstratat navale për të frikësuar Malin e Zi dhe për të penguar furnizimet e saj detare për forcat ushtarake që kishin rrethuar Shkodrën. Por, dihet se Mali i Zi nuk ka pasur flotë detare dhe bllokimi i bregdetit të Tivarit nuk sillte asnjë pasojë për të³⁸.

Qëllimet e demonstrimit naval dolën të qarta edhe nga procedimi i ngjarjeve. Ndërsa më 31 mars 1913 Konferenca e Ambasadorëve aprovoi rezolutën për këtë demonstrim, të nesërmen në mëngjes ambasadori austriak në Londër njoftoi Eduard Grey se një divizion ushtarësh, me një kryqëzor dhe disa torpediniera, nën komandën e kont admiralit Negovan, u nisën për në Tivar...³⁹

Për veprimet austro-hungareze u njoftuan menjëherë qeveritë ruse dhe franceze. Ndërsa, Parisi nuk pranoi të marrë pjesë në demonstrim ministri i Jashtëm rus Sazonov, i shqetësuar shumë, thirri ambasadorin anglez Buchanan dhe i deklaroi se “Austria nuk duhet të lejohej të vepronte vetëm...Prezenca e anijeve britanike duhet të shpëtojë situatën, bile ato janë të vetmet përballë Austrisë...”⁴⁰

Pasi mori përgjigjen e Qeverisë ruse, E. Grey ju desh të bindë edhe Qeverinë franceze. Në një telegram urgjent që i dërgonte ai ambasadorit anglez në Paris, Bertie, i thoshte se: “Rusia dëshiron që Anglia dhe Franca të marrin pjesë bashkërisht në demonstratat navale. Është kjo arsyeja që unë kam përkrahur pjesëmarrjen...Në qoftë se nuk do të marrin pjesë kolektivisht në këto demonstrime do të bëhet shkak i veprimeve të njëanshme të Austrisë ose së bashku me Italinë, për të bërë që të respektohet marrëveshja mbi shqiptarët”.⁴¹ Por ky qëllim del edhe më i qartë nga rezultatet që u arritën me këtë demonstrim. Siç dihet veç ekuipazhit austriak që përmend, morën pjesë: skuadrilja e tretë e luftës “King Eduard VII” e Britanisë së Madhe që ishte ankoruar në Korfuz, dy kryqëzorë francezë, kryqëzori gjerman “Breslaw” dhe një skuadrilje italiane. Të gjithë këto arritën në Tivar më 5 prill 1913⁴².

Në krye të demonstrimit naval, sipas marrëveshjes së përbashkët u vu admiral anglez Burney i cili më 10 prill i dërgoi një telegram mbretit të Malit të Zi, Nikollës, ku i thoshte se “flota ndërkombëtare është stabilizuar

38 AIHT, A-IV-218.

39 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 635, dok. Nr. 781.

40 Sergej Dimitrijeviç Sazanov, *Kujtime...* vep e ci. f. 220.

41 Erik Goldstein & B.J.C Mc Kercher, Power and Stability, *British Foreign Policy 1865-1965...* vep e cit., f. 82.

42 AIHT, A-IV-218.

në bregdetin nga Tivari gjer në rrjedhjen e Drinit... dhe asnjë anije nuk do të lejohet të hyjë në këto ujëra. Anijet që janë në port do të lejoheshin të dilnin".⁴³ Pra, Britania e Madhe përmes admiralit të vet tregonte seriozitetin dhe fuqinë e saj përballë malazezëve "të llastuar" të cilët të përkrahur nga Rusia nuk hiqnin dorë nga pretendimet e veta edhe përkundër vendimeve të Fuqive të Mëdha pjesëmarrëse në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Duke pasur parasysh karakterin formal të këtyre demonstrimeve, Austria vazhdonte të bënte presione për ndërhyrje të njëanshme. Përballë këtyre kërcënimeve, Eduar Grey thirri më 9 prill 1913 ambasadorin gjerman dhe i kërkoi të ndërhynte që "...Austria të mos merrte ndonjë masë të njëanshme në rast se binte Shkodra"⁴⁴.

Krahas kësaj përpjekje, me qëllim që Mali i Zi të hiqte dorë nga pretendimet e tij për Shkodrën, me iniciativën e Eduard Greyt – Malit të Zi ju siguroa nga Fuqitë e Mëdha një hua prej 1.306.000 sterlina për rregullim financiar dhe humbjet e luftës. Por përsëri Qeveria malazeze qëndronte në pozitat e saj⁴⁵. Më 10 prill 1913, i dërguari i Qeverisë malazeze M. Popoviç, u takua me zv. sekretarin e shtetit për Punët e Jashtme të Britanisë A. Nikolson dhe deklaroi se ishte udhëzuar nga qeveria e tij të bënte të ditur se Mali i Zi ka vendosur në mënyrë të prerë të vazhdojë përpjekjet për pushtimin e Shkodrës dhe nuk do të tërhiqet andej me asnjë kompensim territorial apo financiar⁴⁶.

Qëllimi i Malit të Zi për këtë qëndrim të vendosur ishte që ashtu si Serbia, të shfrytëzonte pozitat e saj në Shkodër për të siguruar përfitime sa më të shumta territoriale dhe financiare⁴⁷. Për këtë arsye ajo kish vënë gjithë potencialin e saj ushtarak për pushtimin e qytetit, por nuk mund të çonte rezistencën e madhe që i bëhej. Në këto kushte malazezët depërtuan në rrugët e fshehta, duke shtënë në dorë Esad Pashë Toptanin ish komandant i garnizonit të Shkodrës. Në një mesazh që i dërgoi komandantit të trupave malazeze, më 22 prill 1913, Esati pranoi takimet e drejtpërdrejta. Dhe në këtë mënyrë, Shkodrës ju përgatit pas shpine marrëveshja e pa besë për dorëzimin e qytetit forcave malazeze, duke u njohur të drejtën atyre jo vetëm mbi Shkodrën por gjer në shtratin e lumit Drin. Nga ana e tyre malazezët morën përsipër të lejonin tërheqjen nga Shkodra të garnizonit ushtarak, njohjen e Esatit si princ të Shqipërisë dhe dhënien atij të 16.000 napolonave flori⁴⁸. Si rezultat i kësaj marrëveshjeje të Esat Toptanit me

43 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 669, dok. Nr. 826.

44 Po aty dok. Nr. 824.

45 Isa Bicaç, vep e cit. f. 183.

46 AIHT, A-IV-218.

47 DACG-Cetinje. "Cetinski Glasnik"- Cetinje.

48 Isa Bicaç, vep e cit. f. 185.

Malin e Zi, Shkodra e rrethuar qysh më 15 tetor 1912, vendi ku u bënë heroizma të panumërta, ju dorëzua armiqve pa luftë më 23 prill 1913. Ky lajm u botua si sensacion në të gjitha organet kryesore të shtypit evropian.

Ditën kur forcat malazeze përgatiteshin për të hyrë në Shkodër, ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë thirri ambasadorin anglez F.Karturajt dhe i deklaroi se “Bllokada nuk kish dhënë rezultate. Ajo ishte hapi i parë, tani duhet të bëhet zbarkimi. Në rast se zbarkimi nuk do të bëhet nga Fuqitë e Mëdha, neve do të marshojmë, vetëm ose me Italinë”⁴⁹, kërcënohej Vjena.

Deklarata zyrtare e Qeverisë austriake e detyroi Eduard Greyn që ta shqyrtojë përsëri çështjen në Konferencën e Ambasadorëve, ku më 26 prill 1913 arritën unanimisht të njëtojnë Malin e Zi të lironte Shkodrën se ndryshe do të kishte përballë Fuqitë e Mëdha. Krahas kësaj, Eduard Grey kërkoi ndërhyrjen e Rusisë. Në telegramin që i drejtoi ai ambasadorit Bukanan ndër të tjera i thoshte se: “...unë i them mbretit të Malit të Zi, se në rast se do të shqyrtojë vendimin e Fuqive të Mëdha për evakuimin e Shkodrës, do të diskutohen me të kompensime të arsyeshme, ndryshe Britania e Madhe nuk do t’i japë asnjë përkrahje.⁵⁰ Grey është aq i shqetësuar se arriti të deklarojë se megjithëse për Britaninë e Madhe do të ishte e vështirë pjesëmarrja në aksione ushtarake kundër Malit të Zi, ajo nuk do të kundërshtonte pjesëmarrjen e ndonjë fuqie tjetër të madhe për të dërguar në vend vendimin e Konferencës së Ambasadorëve. Kjo deklaratë e bërë qëllimisht, nga Grey, e tronditi aq shumë mbretin e Malit të Zi, sa e konsideroi një nxitje për Austrinë. Në këto kushte ai zbuti qëndrimin e tij dhe me anë të dërguarit të tij në Londër njoftoi menjëherë E.Greyn se: “... sipas opinionit të Qeverisë së tij, për t’i lënë Shkodrën Shqipërisë, Fuqitë e Mëdha duhet t’i akordojnë asaj disa kompensime territoriale dhe disa ndihma financiare”⁵¹.

Kërkesën e Qeverisë malazeze Eduard Grey ia paraqiti Konferencës së Ambasadorëve duke bërë para tyre këtë deklaratë: “Në qoftë se Qeveria malazeze do të lirojë Shkodrën, ajo do të presë ndihma financiare nga Fuqitë e Mëdha. Në qoftë se nuk e liron Shkodrën, sigurisht ajo do të dëbohet me një mënyrë apo tjetrën, duke humbur edhe rastin për ndihma nga Fuqitë e Mëdha”.⁵² Këto deklarime të britanikëve, disa qarqe malazeze i interpretuan si kërcënime kundër tyre dhe si fillim të humbjes së simpatisë së Londrës ndaj Malit të Zi dhe përkrahje të shtetit shqiptar të sapo njohur ndërkombëtarisht. Presionet e Eduard Greyt kishin për qëllim frenimin me çdo kusht të veprimeve të njëanshme të Austrisë që tanimë ishin shumë

49 AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 707, dok. Nr. 870.

50 Po aty dok. Nr. 984.

51 Po aty dok. Nr. 922.

52 Po aty

serioze. Një ndërhyrje e tillë do të kishte pasoja serioze për shkak se veprimet ushtarake do të shtriheshin në territorin e Malit të Zi dhe ndoshta flaka e luftës do të përhapej në tërë Evropën⁵³. Veç kësaj, Grey ishte njoftuar nga ambasadori anglez në Romë, Rod, se në qoftë se Austria do të marshonte në veri të Shqipërisë, Italia do të gjente ndonjë farë preteksti për të sulmuar në Shqipërinë e Jugut duke pushtuar jo vetëm Vlorën dhe Sazanin, por edhe Sarandën.⁵⁴ Këto lajme i pohonte edhe ambasadori anglez në Berlin, E.Goshen në telegramin sekret që i dërgonte Greyt më 4 maj 1913.⁵⁵

Qëllimi i Britanisë së Madhe për presionet që bënte mbi Malin e Zi del i qartë edhe nga telegrami që ambasadori Anglez në Francë, F. Bertie, i dërgonte E. Greyt më 4 maj 1913, ku ndër të tjera i thoshte: “Neve nuk mund të pranojmë ndarjen e Shqipërisë nga Austria dhe Italia, për shkak se Adriatiku do të pushtonte së qeni neutral dhe se bilanci i fuqive në Mesdhe do të kishte pasoja serioze në qoftë se Italia do të mbante Tobronk dhe Rhodes”.⁵⁶

Më 4 maj 1913 Austria vuri në gatishmëri luftime forcat e saj dhe urdhëroi demonstrime navale të njëanshme në Tivar. Ky qëndrim i vendosur i Austrisë e tronditi Qeverinë ruse dhe ndërhyri urgjent pranë mbretit të Malit të Zi, për të pranuar menjëherë kërkesën e Fuqive të Mëdha për lëshimin e Shkodrës. Mali i Zi nuk kishte as gjasa minimale në përballje eventuale me Austrinë.

Përpara kësaj situatë, Mbreti Nikola, njoftoi telegrafisht Eduard Greyt se pranonte dorëzimin e qytetit forcave ndërkombëtare. Ky telegram u lexua para Konferencës dhe më 5 maj 1913 Eduard Grey ia bëri të ditur edhe Dhomës së komunave, duke e konsideruar si sukses të përpjekjeve të tij⁵⁷. Ministri i Jashtëm britanik, sukseset e tij në vendosjen e kufijve në Ballkanin e trazuar i përdorte politikisht edhe për konsum të brendshëm në Britani. Kështu ai çdo ditë e më shumë konsiderohej si një diplomat i rryer i cili gjente zgjidhje edhe për situatat më të komplikuar. Në këtë mënyrë, sipas marrëveshjes që u arrit në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, nga flota ndërkombëtare u përgatit një detashment prej 500 oficerësh dhe ushtarësh për të marrë në dorëzim qytetin e Shkodrës nga ushtritë malazeze. Dorëzimi i këtij qyteti ju bë më 14 maj 1913, nen-admiralit Burney. Mbi kështjellë u vendos me ceremoni flamuri i flotës ndërkombëtare. Statuti i

53 G. P. Gooch, D. Litt., and Harold Temperley, Litt. D. with the assistance of Lillian M. Penson. PhD. *The Balkan Wars...* f. 50.

54 Po aty

55 AIHT. Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 943.

56 Po aty, dok. Nr. 945.

57 G. P. Gooch, D. Litt., and Harold Temperley, Litt. D. with the assistance of Lillian M. Penson. PhD. *The Balkan Wars...* f. 51.

qytetit u bë i njohur nëpërmjet një proklamate të botuar në gjuhën angleze dhe shqipe nga përfaqësuesit e flotës.

Bazuar në këto vendime Fuqitë e Mëdha e zgjidhen "Çështjen e Shkodrës" dhe të kufijve verior e veri-lindor të Shqipërisë. Ambasadori anglez në Vjenë F.Karturajt, në një letër joformale që i dërgonte E.Greyt, më 9 maj 1913, ndër të tjera i thoshte: "Në qarqet qeveritare në përgjithësi besohet se e gjithë çështja e Shkodrës, që ka preokupuar Evropën gjatë javëve të kaluara u ngrit nga mbreti Nikolla me të vetmin qëllim që ta ndihmonte atë të kryejë një "coup de bourse" në opinionin publik Evropian".⁵⁸

Me qëllim që të përfundohej çështja e kufirit verior dhe lindor në hollësi, Konferenca e Ambasadorëve aprovoi më 16 maj krijimin e një komisioni kufitar, të përbërë nga oficerë specialistë nga të 6 Fuqitë e Mëdha. Përfaqësuesi i Britanisë së Madhe në këtë komision ishte atasheu ushtarak në Romë, koloneli Granet. Komisioni filloi punën e tij në shtator të vitit 1913, por i ndërpreu punimet në dimër për shkak të vështirësive të mëdha atmosferike⁵⁹, në pamundësi për t'i vazhduar më tej.

Marrëveshja e arritur nga Fuqitë e Mëdha për kufijtë veriorë dhe lindorë të Shqipërisë ngjalli zemërimin më të madh dhe revoltat e armatosura. Kështu, krahas protestave të vendosura që u dërguan Fuqive të Mëdha, u organizuan në rajonet e okupuara çeta të armatosura për çlirimin e vendit të tyre nga pushtuesit serbë. Shqiptarët e këtyre zonave e kishin mirëpritur pavarësinë e shtetit shqiptar dhe dëbimin e Perandorisë Osmane që kishte mbajtur të pushtuara tokat shqiptare për shekuj me radhë por ishin jashtëzakonisht të revoltuar për vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër që cenonin territoret etnike shqiptare.

⁵⁸ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, dok. Nr. 968.

⁵⁹ AIHT, A-IV-218.

Prof. asc. Dr. Frashër DEMAJ

SUMMARY

**THE GREAT POWERS DIPLOMACY ALTERNATIVES FOR
ALBANIAN-MONTENEGRIN BORDER IN THE LONDON
CONFERENCE OF AMBASSADORS**

The Governments of allied Balkan states by the end of 1912 and beginning of January submitted their views regarding the new geography of Balkans. especially presented their ideas, proposals and positions on territorial changes that should take place in Balkan Peninsula. These views demonstrated invasive tendencies mainly of Serbia, Montenegro and Greece all of which were subjected against Albanian lands.

The issue of borders in the London Conference of Ambassadors instigated difficult diplomatic debate between the Great Powers which defending their positions displayed potential alternatives on determination of Albanian state.

Eduard Grey made relentless efforts to convince ambassadors to accept Ambassador Benkendorf's proposal that northeastern border of Albania continuing align Ohri Lake and Black Drin River with Dibra within Albania's side, and finally closing it along White Drin to the Buna - Rivers and into the Adriatic. Vienna's demand for Shkodra remain in Albania collided with Russia's opposition that was supported by France and the Great Britain. Italy backed Austro-Hungarian position for a new Albanian state, but regarding Shkodra issue it showed indecisive for its specific interest.

In this situation Italy changed its positions and lined up with Austria causing for Ambassadors to split in two sides: Britain, Russia and France for Russian project, and Germany, Austro-Hungary and Italy against it.

The Ambassadors Conference aiming to conclude in detail the issue of Northern and Eastern borders on May 16 approved establishment of the new border commission gathering specialist officers from the six Great Powers. The commission commenced its work on September 1913, but on winter came into stall for terrain hitches. The agreement of the Great Powers for Albania's North and Eastern borders instigated a lot of anger, discontent and armed revolts.